

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komunes se Gjilanit**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr <sup>1</sup> i prokurimit	203/40300-26-1677-2-6-10
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit me titull: "Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR-Mitrovicë ,DR-Ferizaj , DR-Gjilan dhe Blinajë - Lot 1"

### ANKESË

**Emri i plotë i kompanisë:** Rabbit Latifi B.I (NTP "BLINI&CATI")

**Adresa:** Rr.Ramiz Cernica

**Vendi:** Gjilan

**Kodi postar:** 60000

**Numri Telefonit:** 044/161-30

**Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj:** Rabbit Latifi

**Adresa elektronike:** rabbitlatifi1965@gmail.com

**Data e parashtrimit të ankesës** 29.06.2026

**Nënshkrimi dhe vula:**



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës];*

Data	Përshkrimi i kronologjisë procedurale të aktivitetit
31.03.2026	Publikimi i Njoftimit për Kontratë - procedurë e hapur, Vlera totale e parashikuar: 424,823.88 € Kriteri për dhënie: Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të lartë.
20.04.2026	Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve - ora 14:00
08.06.2026	Njoftim mbi Vendimin e AK se bashku me letrat standarde të tenderuesve
10.06.2026	Qasja zyrtare në dosjet e OE pjesëmarrës në këto aktivitete
12.06.2026	Parashtrimi i Kërkesës për Rishqyrtim
18.06.2026	Vendimi i AK për refuzimin si të pabazuar të Kërkesës për Rishqyrtim
24.06.2026	Perseritje e kërkesës për qasje zyrtare në dokumente të caktuara në dosjen e GOE "Euro-Model & Perspektiva V Sh.p.k.
29.06.2026	Parashtrimi i ankesës në OSHP

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

Jo

Jo. Për faktin se sipas nenit 35.1 të RRPP, hapja e tenderit kryhet duke përdorur funksionalitetin e hapjes së tenderit në sistemin elektronik të prokurimit.

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Më datë 12.06.2026, kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim, e cila është mbeshetur me deshmi dhe fakte të mjaftueshme që vertetojnë se procesi i vleresimit, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertuesve, dhe veçanërisht Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 08.06.2026 sa i përket LOT 1 për eliminimin e ofertës tone dhe dhenien e kontratës GOE "Euro-Model & Perspektiva V Sh.p.k. është vendosur në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat e nenit 59 dhe 60 lidhur me nenin 1,6,7 dhe 24 të LPP, përfshirë dispozitave të ndërlidhura të RRPP.

Megjithatë, AK- Agjencioni Pyjor, me vendimin e datës 18.06.2026, e ka refuzuar kërkesën si të pabazuar, duke e lënë në fuqi vendimin për anulimin e aktivitetit.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Parashtruesi konsideron se akti i kontestuar për anulimin e aktivitetit të prokurimit, duke përfshirë edhe veprimet që i kanë paraprirë dhe e kanë shkaktuar këtë vendim të paligjshëm, janë nxjerrë në kundërshtim me parimet e sigurisë juridike dhe dispozitave ligjore të LPP Nr. 04/L-041 (Versioni i Konsoliduar) dhe RRPP Nr. 02/2024 (Versioni i Konsoliduar), si me poshte:

- **Nenin 1** në paragrafin 2 dhe 3 i LPP lidhur me nenin 4.3 i RRPP;
- **Nenin 6** në paragrafin 1 lidhur me nenin 4.3 në pikat c, f, g të RRPP;
- **Nenin 7** në paragrafin 1, 2, 4 i LPP lidhur me nenin 4.3 në pikat c, f, g të RRPP;
- **Nenin 24** në paragrafin 2 të LPP
- **Nenin 59** në par. 4 të LPP lidhur me nenin 39 dhe nenin 40 par. 1, 2, 6 të RRPP
- **Nenin 60** në paragrafin 1.1 të LPP lidhur me nenin 40 në paragrafin 13 të RRPP;

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

### Rrethanat procedurale të aktivitetit në fjalë.

- Me 31.03.2026, Agjencioni Pyjor në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar në procedurë të hapur dosjen e tenderit për shitjen e asetëve përmes prokurimit publik me titull: "Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR-Mitrovicë, DR-Ferizaj, DR-Gjilan dhe Blinajë" për 9 pjesë/lotë, me numër të prokurimit 203/40300-26-1677-2-6-10, me vlerë të parashikuar prej 424,823.88 €
- Parashtruesi i kërkesës, Rabbit Latifi B.I. (NTP "BLINI & CATI"), ka marrë pjesë si ofertues në tri lotë (Loti 1, Loti 2 dhe Loti 3) të tenderit të lartpërmendur. Ai ka përmbushur në tërësi të gjitha kriteret e kualifikimit dhe kriterin e dhënies së kontratës për Lotin 1, pasi ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me ofertën e renditur me çmimin më të lartë ndër ofertat e përgjegjshme, për të cilën, sipas kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit, duhet t'i jepet kontrata.
- Më 08.06.2026, AK- Agjencioni Pyjor, duke vepruar dhe vendosur në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe me dispozitat përkatëse/relevante të LPP si ligj material, të cilat rregullojnë vlerësimin e ofertave dhe dhënien e kontratës, përmes Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe letrave standarde për Lotin 1, ka vendosur të eliminojë ofertën tonë dhe t'ia japë kontratën GOE "Euro-Model & Perspektiva V Sh.p.k.", ndonëse oferta e këtij GOE nuk i plotësonte kriteret e kualifikimit dhe as kriterin për dhënien e kontratës, pasi nuk ishte oferta e përgjegjshme me çmimin më të lartë, siç kërkohej shprehimisht nga dosja e tenderit.
- Për këto arsye, duke qenë se të drejtat tona të garantuara me LPP janë cenuar dhe vazhdojnë të rrezikohen nga veprimet e kundërligjshme të AK-së, nëse vendimi në fjalë mbetet në fuqi, si dhe pasi kemi siguruar faktet dhe provat relevante përmes realizimit të qasjes zyrtare në dokumentacionin e ofertës së OE-së në fjalë, më 12.06.2026 i kemi drejtuar AK - Agjencionit Pyjor me kërkesë për rishqyrtim. Me këtë kërkesë të mbështetur në fakte dhe prova relevante që vërtetojnë se veprimet dhe vendimi i AK-së ishte i kundërligjshëm, kemi kërkuar anulimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së dhe të letrave standarde për LOT 1, në pjesën që ka të bëjë me eliminimin e ofertës sonë dhe dhënien e kontratës GOE "Euro-Model & Perspektiva V Sh.p.k."
- Megjithatë, ZPP i AK-së, me vendimin e datës 18.06.2026, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesën tonë për rishqyrtim, duke e lënë në fuqi vendimin për diskualifikimin e ofertës sonë dhe nga ana tjetër dhënien e kontratës GOE "Euro-Model & Perspektiva V Sh.p.k.". Arsyetimi dhe thëniet e paraqitura në vendimin e kundërshtuar nuk përputhen me gjendjen e saktë faktike në raport me përmbushjen e kriterëve të kualifikimit dhe kriterit të dhënies së kontratës, të përcaktuara në dosjen e tenderit. Po ashtu, ato nuk janë në përputhje me dispozitat përkatëse të LPP-së, si ligj material, dhe të RRPP-së, si legjislacion sekondar, të cilat rregullojnë vlerësimin e ofertave dhe dhënien e kontratës.
- Për këto arsye, me anë të kësaj ankese i drejtohem OSHP-së me qëllim të mbrojtjes së të drejtave tona të garantuara me LPP, mbrojtje e cila mund të sigurohet vetëm përmes një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm të institucionit tuaj, në përputhje me nenet 104, 105 dhe 117 të LPP-së.

## Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore

### Pretendimi i parë

Pretendimi i parë ndërlidhet me kundërshtimin e vendimit të AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE ankues, si një vendim i pabazuar në fakte dhe në dispozitat përkatëse ligjore. Njëkohësisht, ky pretendim ndërlidhet edhe me paraqitjen e fakteve dhe provave të reja relevante, të cilat janë bërë të ditura për ne vetëm pas realizimit të qasjes zyrtare në dosjen e GOE "Euro-Model & Perspektiva V Sh.p.k.", në bazë të të cilave vërtetohet se i njëjti është i papërgjegjshëm, pasi nuk i përmbush kërkesat formale të dosjes së tenderit nga aspekti administrativ, kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në FTD, si dhe kriterin e dhënies së kontratës - ofertën e renditur me çmimin më të lartë ndër ofertat e përgjegjshme.

1. Zyra e Prokurimit e AK - Agjencionit Pyjor, me anë të vendimit të datës 18.06.2026, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim me arsyetimin se pretendimet nuk qëndrojnë (pa nevojë të përsëriten - referoju vendimit të kundërshtuar), dhe e ka vërtetuar Njoftim Vendimin e AK-së të datës 08.06.2026.
2. Pas analizimit të vendimit të kontestuar në raport me të gjitha shkresat e lëndës dhe bazën ligjore në fuqi, OE ankues ka konstatuar se vendimi përmban shkelje thelbësore të parimeve bazike të prokurimit dhe dispozitave të LPP, si ligj material, dhe të RRPP, si legjislacion sekondar, që rregullojnë vlerësimin e ofertave dhe dhënien e kontratës. Arsyetimi dhe thëniet e paraqitura në vendimin e kundërshtuar nuk janë të mbështetura në fakte dhe prova juridikisht të vërtetuara në raport me gjendjen e plotë faktike lidhur me kriteret e kualifikimit dhe kriterin e dhënies së kontratës "çmimi më i lartë" të specifikuar në dosjen e tenderit, dhe as në dispozitat relevante të neneve 1, 6, 7, 59, 60 dhe 69 të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë shprehimisht situata të tilla që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti prokurimi.
3. Njëkohësisht, ZPP i AK - Agjencionit Pyjor nuk ka shfaqur asnjë interes dhe ka hezitur të shqyrtojë thelbin e pretendimeve kryesore, përkatësisht faktet dhe provat e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim që vërtetojnë përgjegjshmërinë e ofertës të OE ankues për LOT 1, dhe njëkohësisht papërgjegjshmërinë e GOE fitues për LOT 1. Kjo mungesë e analizës objektive, e cila është thelbi i vetë pretendimeve kryesore ankimore, tregon se ZPP nuk ka shqyrtuar fare çështjen në themel, por është kufizuar në një konstatim formal, duke iu referuar vetëm fakteve që janë në favor të saj dhe të interesave të GOE fitues, dhe duke anashkaluar faktet vendimtare që dëshmojnë se oferta e GOE fitues është e papërgjegjshme, si dhe faktet që dëshmojnë se oferta e OE ankues është e përgjegjshme. Një veprim i tillë bie ndesh me detyrimet dhe përgjegjësitë ligjore të ZPP sipas nenit 24 të LPP, lidhur me dispozitat materiale të neneve 59 dhe 60 të LPP, dhe e privon ankuesin nga e drejta për një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe në përputhje me pritjet legjitime dhe të arsyeshme që ka pasur.

Në vijim, parashtrijmë pretendimet konkrete dhe faktet vendimtare që ZPP i ka anashkaluar tërësisht, të cilat dëshmojnë papërgjegjshmërinë e GOE fitues dhe përgjegjshmërinë e OE ankues, rrjedhimisht vlerësimin e ofertave në kundërshtim me dispozitat materiale të nenit 59 dhe 60 të LPP:

Faktet dhe provat e pohuara per atakimin e vendimit te kundërligjshëm te AK-se per eliminimin e ofertës së OE ankues Rabit Latifi B.I i njoftuar permes Letres Standarde, dhe i vërtetuar me vendimin per refuzimin e kërkesës per rishqyrtim

4. Vendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës së OE Rabit Latifi B.I. është nxjerrë në kundërshtim me vetë kërkesën nr. 7 të dosjes së tenderit, me nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40 të RRPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë kriteret e vlerësimit dhe dhënies së kontratës, pasi baza ligjore e cituar në arsyetim nuk korrespondon me gjendjen faktike të rastit. Ky pretendim mbështetet ne faktet dhe provat relevante si me poshtë:

- Ankuesi ka paraqitur marrëveshjen e angazhimit me inxhinierin konform kërkesës 7 te dosjes se tenderit, e cila eshte lidhur në mënyrë të rregullt dhe e verifikueshme përmes aktit noterial të datës 17.04.2026, në praninë vetë të inxhinierit. Çdo veprim i mëvonshëm i këtij personi, përfshirë angazhimin e tij të pretenduar nga OE Aferdita Kqiku, ka qenë jashtë dijenisë, kontrollit dhe vullnetit të OE Rabit Latifi B.I. Sipas parimeve themelore të përcaktuara me LPP., parimi i përgjegjësisë personale dhe i barazisë së trajtimit nuk mund të zbatohet në dëm të një OE për shkak të veprimeve të një pale të tretë mbi të cilën ai nuk ka kontroll juridik.
- Rrjedhimisht, eliminimi i ofertës tonë, i mbështetur në nenin 68 paragrafi 4 dhe nenin 69 paragrafi 8 të LPP-së, në ndërlidhje me nenin 18.9 të Rregullores nr. 002/2024, përbën keqinterpretim te qëllimshëm dhe aplikim të gabuar të dispozitave ligjore në fjalë, në mënyrë që të krijohen kushtet për favorizimin e GOE Euro-Model & Perspektiva V për shpërblim me kontratë për Lot 1.
- Këto dispozita rregullojnë rastin e mbështetjes së një operatori ekonomik te kapacitetet e një subjekti tjetër, kur OE deklaroi shprehimisht në ofertën e tij se po mbështetet te burimet e një pale të tretë dhe paraqet si dëshmi një marrëveshje ndërmjet tij dhe atij subjekti, sipas kushteve të përcaktuara në vetë këto nene. Neni 18.9 i RRPP shkon më tej dhe ndalon këtë mbështetje të kryqëzuar te i njëjti kapacitet, kur prokurimi është i ndarë në lote dhe OE pjesëmarrës mbështeten njëkohësisht te i njëjti subjekt për lote të ndara.
- OE Rabit Latifi B.I. nuk ka deklaruar dhe nuk ka pretenduar mbështetje te kapaciteti i ndonjë operatori ekonomik tjetër. Inxhinieri/teknik i pylltarisë është paraqitur si person i angazhuar drejtpërdrejt nga vetë OE përmes aktit noterial të datës 17.04.2026, në praninë vetë të inxhinierit. Pra mungon elementi që aktivizon zbatimin e dispozitave të cituara nga AK, që është marrëdhënia e deklaruar e mbështetjes formale ndërmjet dy operatorëve ekonomikë. Fakti që i njëjti person ka qenë i angazhuar paralelisht nga dy subjekte të ndryshme, pa dijeni e pa marrëveshje ndërmjet tyre, nuk e bën këtë rrethanë "mbështetje te kapaciteti i palës së tretë" sipas këtyre dispozitave, sepse ato kërkojnë shprehimisht ekzistencën e një marrëveshjeje apo deklarimi të ndërsjellë ndërmjet OE-ve, element që mungon tërësisht në rastin konkret. Për këtë arsye, zbatimi i tyre ndaj OE Rabit Latifi B.I. për per rrethanë që ajo nuk e rregullon përbën vlerësim në kundërshtim me parimet dhe kriteret ligjore të LPP-së dhe RRPP-së.

- Megjithatë, edhe sikur arsyetimi i AK-së të pranohej si i bazuar në momentin e vlerësimit të ofertave, ai nuk mund të qëndrojë më për shkak të një rrethane të pakontestueshme juridike. Konkretisht, OE Aferdita Kqiku, e eliminuar nga e njëjta procedurë për të njëjtën arsye, nuk ka ushtruar asnjë mjet juridik kundër vendimit të eliminimit të datës 08.06.2026. Me këtë mosveprim, ky operator ekonomik ka hequr dorë nga çdo interes i mëtejshëm material në këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 nënparagrafi 1.26, lidhur me nenin 111 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të LPP-së. Për rrjedhojë, vendimi për eliminimin e tij ka marrë formë të prerë dhe nuk mund të prodhohë më asnjë pasojë juridike ndaj operatorëve të tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë. Si rezultat, nuk ekziston më asnjë bazë faktike apo juridike për të pretenduar se i njëjti kapacitet teknik është duke u përdorur njëkohësisht nga dy operatorë ekonomikë. Me eliminimin përfundimtar të OE Aferdita Kqiku, nuk ekziston më asnjë palë tjetër aktive në procedurë ndaj së cilës mund të ngrihet pretendimi për “dyfishimin: e kapacitetit teknik. Për rrjedhojë, inxhinieri në fjalë mbetet, për qëllimet e kësaj procedure të prokurimit, i lidhur juridikisht dhe në dispozicion ekskluziv të OE Rabbit Latifi B.I., në bazë të marrëveshjes së noterizuar dhe të vlefshme të paraqitur në ofertë.
- Në këto rrethana, AK nuk kishte më asnjë bazë ligjore për të mbështetur eliminimin e OE Rabbit Latifi B.I. në pretendimin për përdorim të dyfishtë të të njëjtit kapacitet teknik, pasi kjo rrethanë kishte pushuar së ekzistuari dhe nuk prodhonte më asnjë efekt juridik në procedurë. Për rrjedhojë, arsyetimi i përdorur nga AK nuk mund të konsiderohet si një bazë e ligjshme për eliminimin e ofertës sonë, por paraqitet si një pretekst formal që ka mundësuar shpërblimin e GOE Euro-Model & Perspektiva Vme kontratë për Lotin 1, ndonëse ky GOE kishte paraqitur çmimin më të ulët ndër operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kriterin e çmimit më të lartë të përcaktuar në nenin 21.1 të FTD-së
- Prandaj, arsyetimi i AK-së është juridikisht i paqëndrueshëm, pasi mbështetet në një rrethanë ineksistente dhe në një kriter që nuk ka qenë i parashikuar në dosjen e tenderit, në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, ndërsa operatori ekonomik për të cilin pretendohet ekzistenca e konfliktit nuk është më palë aktive në këtë procedurë. Për këtë arsye, vendimi për eliminimin e ofertës së OE Rabbit Latifi B.I. është i papabazuar dhe duhet të anulohet.

**Faktet dhe provat e siguruar gjatë qasjes zyrtare lidhur me papërgjegjshmërinë e GOE Euro-Model & Perspektiva V Sh.p.k.**

5. Bazuar në dispozitat relevante të neneve 59 dhe 60 të LPP, si ligj material për prokurimin publik, në ndërlidhje me nenin 40 paragrafët 6 dhe 13 të RRPP, përcaktohen qartë kriteret sipas të cilave një tender konsiderohet i përgjegjshëm, përkatësisht kur oferta është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit, kur përmbush kriteret e përzgjedhjes dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dosje, si dhe kur është në përputhje me kriteret e dhënies së kontratës të specifikuar në dosjen e tenderit ose në njoftimin për kontratë.
6. Pas qasjes zyrtare që kemi pasur në dokumentet e dosjes së tenderit me të cilën ka ofertuar GOE Euro-Model & Perspektiva V Sh.p.k., i shpërblyer me kontratë për LOT 1, është gjetur se i njëjti është i papërgjegjshëm, pasi nuk i përmbush kërkesat formale të

dosjes së tenderit nga aspekti administrativ, nuk i përmbush të gjitha kërkesat e përzgjedhjes dhe kualifikimit të përcaktuara në FTD, dhe nuk e përmbush kriterin e dhënies së kontratës - ofertën e renditur me çmimin më të lartë ndër ofertat e përgjegjshme.

### Pika e parë


#### 7. Nuk i përmbush kërkesat formale të dosjes së tenderit nga aspekti administrativ siç përcaktohet me nenin 40.6 (a) të RRPP

- Bazuar në bazën ligjore dhe faktike në raport me dokumentacionin e dosjes së tenderit me të cilin GOE në fjalë ka ofertuar, siç konfirmohet në platformën e-Procurement, rezulton se Deklarata për Themelimin e Grupit, e miratuar nga KRPP, nuk është plotësuar në të gjitha pikat e kërkuara, ashtu siç përcaktohet me nenin 26 paragrafi 15 të Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Ky nen përcakton se, kurdo që Operatorët Ekonomikë marrin pjesë si grup, ata duhet të ofrojnë, së bashku me ofertën e tyre, një Marrëveshje për Themelimin e Grupit, në të cilën të përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve, si dhe veprimet procedurale që lideri i grupit duhet të kryejë në emër të grupit.
- Në formën standarde të kësaj deklarate kërkohet, në mënyrë obligative, ndarja në përqindje (%) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës, si dhe ndarja e përgjegjësisë për të gjithë anëtarët e grupit të Operatorëve Ekonomikë që marrin pjesë me ofertë të përbashkët.
- Megjithatë, duke ju referuar Deklaratës për Themelimin e Grupit të GOE të rekomanduar për kontratë, rezulton se kjo kërkesë ligjore nuk është respektuar. Për faktin se, konkretisht, në dokumentin e paraqitur me numër rendor "6 Deklaratë për Konzorcium.pdf" në skedarin DOK 1.rar, vërehet se pika 5, nën-pikat a) dhe b), nuk janë plotësuar, pavarësisht se aty kërkohet që lideri dhe çdo anëtar i grupit të konfirmojnë dhe deklarojnë ndarjen në përqindje (%) të pjesëmarrjes në realizimin e kontratës. Në mënyrë të ngjashme, nuk është plotësuar edhe pika 6, nën-pikat a) dhe b), ku kërkohet të deklarohet ndarja e përgjegjësisë për secilin anëtar veç e veç - përgjegjësitë e liderit dhe përgjegjësitë e anëtarit.
- Përkundrazi, struktura origjinale e formularit të deklaratës për themelimin e grupit është modifikuar, ku brenda pikës 5 është shtuar artificialisht një numër i ri "6", duke e çrregulluar renditjen dhe duke e zhvendosur me një numër pikën pasuese që në fakt duhet të jetë pika e përgjegjësisë të anëtarëve të grupit, dhe në të njëjtën kohë, nën-pikat përkatëse të të dy pikave, ku kërkohet të deklarohet përqindja e pjesëmarrjes dhe përgjegjësitë e liderit dhe anëtarëve, janë mbuluar tërësisht me shirit të zi. Ju lutem shihni si dëshmi pjesën e mëposhtme të shkëputur nga Deklarata për Themelimin e Grupit që është paraqitur nga GOE "Euro-Model & Perspektiva V Sh.p.k.",



nën pikën a) për paraqitjen e Vërtetimit nga APK se nuk ka obligime të papërmbushura nga kontratat e mëparshme në APK.

- Pas verifikimit të dokumentacionit të ofertës së GOE Euro-Model & Perspektiva V Sh.p.k., të shpërblyer me kontratë për LOT 1, të siguruar gjatë qasjes zyrtare në dokumentacion, rezulton se në skedarin DOK 1.rar nuk është paraqitur Vërtetimi nga APK, i kërkuar sipas dosjes së tenderit. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një mangësi formale të dokumentit, por me mungesën e plotë të dëshmisë së kërkuar. Nga dokumentet e ngarkuara në skedarin **DOK 1.rar** rezulton se, janë ngarkuar vetëm dokumentet **"7 Kërkesa AP Perspektiva.pdf"** dhe **"KERKESA APK.pdf"**, të cilat paraqesin kërkesën drejtuar APK-së, por jo vërtetimin e kërkuar nga DT.



Name	Size	Packed	Type	Modified	CRC32
..			File folder		
1 Deklarata nën Betim + Deklaratat.pdf	114,405	106,835	Foxit PDF Edit...	4/19/2026 2:03 PM	7D427E32
2 ARBK+TVSH Perspektiva.pdf	3,053,160	2,749,794	Foxit PDF Edit...	4/17/2026 1:01 PM	DC051946
3 ARBK_EUROMODEL.pdf	626,379	585,512	Foxit PDF Edit...	4/18/2026 9:24 PM	1F43B54E
4 Certifikata e Tvsh Euro-Model.pdf	2,026,677	2,016,598	Foxit PDF Edit...	4/17/2026 10:27 AM	D4CE6178
5 Deklaratë per Konzercium.pdf	83,236	77,648	Foxit PDF Edit...	4/19/2026 3:37 PM	50496D67
6 Inspektorati dhe kërkesa APK.pdf	242,753	230,882	Foxit PDF Edit...	4/19/2026 2:16 PM	BD615188
7 Kërkesa APK Perspektiva.pdf	50,946	48,246	Foxit PDF Edit...	4/19/2026 3:59 PM	283C3120
8 Vertetimi Tatimor ATK Euro-Model.pdf	698,710	646,327	Foxit PDF Edit...	4/17/2026 12:32 PM	2E3C288B
9 Vertetimi Tatimor ATK Perspektiva.pdf	636,773	580,697	Foxit PDF Edit...	4/17/2026 4:22 PM	0E070C6C
KERKESA APK.pdf	1,057,646	1,052,700	Foxit PDF Edit...	4/20/2026 11:46 AM	DDFBD283

- Për më tepër, nga dokumenti **"7 Kërkesa AP Perspektiva.pdf"** rezulton se GOE ka bashkëngjitur tri fotografi me emërtimet **"ËhatsApp Image..."**, të cilat përmbajnë dokumente dhe komunikime të shkëmbyera përmes aplikacionit **ËhatsApp**. Vetë fakti që këto komunikime janë bashkëngjitur si pjesë e dokumentacionit të ofertës ngre dyshime serioze se gjatë kësaj procedure është zhvilluar komunikim jashtë mënyrave të komunikimit të përcaktuara nga legjislacioni i prokurimit publik. Për rrjedhojë, kërkojmë nga OSHP që të verifikojë se ndërmjet cilëve persona është zhvilluar ky komunikim, në çfarë faze të procedurës është realizuar dhe nëse përmes tij janë shkëmbyer informacione ose dokumente ndërmjet GOE-së dhe Autoritetit Kontraktues, me qëllim të ndikojë dhe kufizojë konkurrencën në kundërshtim me rregullat që garantojnë transparencën, barazinë e operatorëve ekonomikë dhe integritetin e procedurës së prokurimit.
- Pavarësisht se nga dokumentacioni i ofertës i ngarkuar në e-prokurimi rezulton se GOE nuk ka paraqitur Vërtetimin nga APK të kërkuar me dosjen e tenderit, ZPP i AK- Agjencionit Pyjor, në arsyetimin e vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 18.06.2026, ka konstatuar se operatori ekonomik posedon vërtetimet e Agjencisë Pyjore të Kosovës me nr. të protokollit NP-1600 dhe NP-1601, të datës 20.04.2026.
- Meqenëse konstatimi i AK-së nuk përputhet me dokumentacionin e ofertës së ngarkuar në platformën e-prokurimi, duke u bazuar në nenin 10 par.3,4 dhe 5 të LPP, i kemi kërkuar ZPP të Autoritetit Kontraktues që të tregojë dhe të vërtetojë me dëshmi konkrete se në cilin skedar të ofertës ndodhen ose janë ngarkuar këto vërtetime, si dhe të na vërë në dispozicion kopjet e tyre si dhe orën e lëshimit sipas librit të regjistrimit/protokollit të AK- Agjencionit Pyjor. Megjithatë, deri në paraqitjen e kësaj ankese, ZPP e Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë përgjigje lidhur me

këtë kërkesë, rrjedhimisht nuk identifikoi asnjë skedar, nuk vuri në dispozicion asnjë dokument dhe nuk ofroi asnjë provë që mbështet konstatimin mbi të cilin e bazoi vendimin. Në vend të kësaj, dha sqarime procedurale lidhur me të drejtën e qasjes në dokumente zyrtare, që nuk kanë asnjë lidhje me kërkesën tonë të specifikuar në mënyrë të qartë dhe konkrete.

- Pra, vetë kjo gjendje faktike vërteton se ZPP i AK – Agjencisë Pyjore të Kosovës ka qenë plotësisht në dijeni se GOE, me rastin e ofertimit, nuk e kishte përmbushur kërkesën minimale të kualifikimit të kërkuar sipas pikës a) të kërkesës/dëshmisë nr. 4 të pikave 4.1 dhe 4.2 të FTD-së, sepse nuk kishte paraqitur Vërtetimin nga APK se nuk ka obligime të papërmbushura nga kontratat e mëparshme në APK. Përkundër kësaj, në vend që ta vlerësonte ofertën në përputhje me gjendjen faktike, kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat përkatëse të LPP-së dhe RRPP-së që rregullojnë vlerësimin e ofertave dhe dhënien e kontratës, ZPP i AK-së, duke ju referuar arsytimit të vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim rezultoi se ka vazhduar me ndërmarrjen e veprimeve që kanë ndryshuar aspektin material të ofertës, në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së dhe pikën 10.1 të Udhëzuesit për Prokurimin Publik, e cila nuk lejon kërkimin e informatave sqaruese në raste të tilla, duke favorizuar GOE-në në kundërshtim edhe me nenin 7 të LPP-së, i cili obligon autoritetin kontraktues t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë, jo diskriminuese dhe transparente.

Për arsyet e lartcekura, GOE nuk e ka përmbushur këtë kërkesë minimale të kualifikimit, ndërsa vlerësimi i ofertës së tij është bërë në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së, në ndërlidhje me nenin 40 paragrafët 1, 2 dhe 6 të RRPP-së.

**E dyta, nuk e përmbush kërkesën 7 të nenit 4.1&4.2 të FTD**

- Autoriteti Kontraktues – Agjencioni Pyjor, përmes kërkesës nr. 7 dhe dëshmisë nr. 7 të nenit 4.1 dhe 4.2 të FTD, ka kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin, Një inxhinier apo teknik i pylltarisë me dëshmitë Diploma-kopje dhe Kontrata e punës, CV( kërkesa për një lot/pjesë).
- Nga dokumentacioni i ofertës së GOE "Euro-Model & Perspektiva V Sh.p.k.", të siguruar gjatë qasjes zyrtare, rezultoi se dëshmitë për përmbushjen e kërkesës nr. 7 janë paraqitur në skedarin "DOK 3.rar", si më poshtë:



↑ DOK 3.rar - RAR archive, unpacked size 8,812,954 bytes

Name	Size	Packed	Type	Modified	CRC32
..			File folder		
10 Menaxher Kontrate lot1,2. Kontrata Sabit Zeneli.pdf	122,087	114,465	Foixit PDF Edit...	4/19/2026 2:46 PM	DEDE49A2
12 Libreza e Makinerise 1_compressed.pdf	1,418,386	1,417,165	Foixit PDF Edit...	4/20/2026 11:25 AM	61519CB8
CV Hasan Ukaj.pdf	1,610,035	1,550,833	Foixit PDF Edit...	6/11/2024 9:23 AM	9820BD16
CV Shtes Hasan Ukaj.pdf	4,700,771	4,322,155	Foixit PDF Edit...	6/11/2024 9:31 AM	EDBC85BD
Diploma Hasan Ukaj.pdf	777,614	745,984	Foixit PDF Edit...	6/11/2024 9:21 AM	4F8F6E2E
Kontrata Hasan Ukaj.pdf	184,061	157,030	Foixit PDF Edit...	4/19/2026 7:28 PM	D61AFCC8

- Nga dokumentet e ngarkuara në skedarin "DOK 3.rar" rezultoi se, për përmbushjen e kërkesës lidhur me stafin profesional, GOE ka paraqitur dokumentacion për dy persona, përkatësisht: Sabit Zeneli, i propozuar si Menaxher i Kontratës, për të cilin janë paraqitur vetëm kontrata e punës, e lidhur më 15.04.2026, dhe një dokument i emërtuar "CV – Shqip", i cili nuk përmban elementet dhe informacionet themelore

të një CV-je; Hasan Ukaj, për të cilin janë paraqitur kontrata e punës, diploma dhe CV-ja me përmbajtje të plotë.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në skedarin DOK 3.rar, rezulton se GOE nuk e ka përmbushur kërkesën nr. 7 dhe dëshminë nr. 7 të pikave 4.1 dhe 4.2 të FTD-së. Për personin S.Z. i propozuar si Menaxher i Kontratës, nuk është paraqitur diploma, ndonëse ajo është kërkuar shprehimisht me dosjen e tenderit. Po ashtu, dokumenti i paraqitur si CV nuk përmban të dhënat bazë profesionale që mundësojnë verifikimin e kualifikimit dhe angazhimit profesional të personit të propozuar, rrjedhimisht nuk e përmbush qëllimin për të cilin është kërkuar si dëshmi në FTD. Sa i përket personit H.U., dokumentacioni i paraqitur ngre dyshime serioze mbi autenticitetin dhe besueshmërinë e kontratës së punës. Konkretisht, në të njëjtën kontratë figurojnë dy data të ndryshme të nënshkrimit. Nga ana e punëdhënësit kontrata është nënshkruar më datë 20.04.2026, ndërsa pranë nënshkrimit të punëmarrësit figuron viti 2025. Këto të dhëna janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën dhe nuk mund të jenë njëkohësisht të sakta për të njëjtin akt juridik. Për më tepër, kontrata nuk përmban vulën e operatorit ekonomik bartës të grupit "Euro-Model Sh.p.k.", gjë që e shton edhe më tej dyshimin mbi autenticitetin e dokumentit të paraqitur. Në këto rrethana nuk bëhet fjalë për një pasaktësi formale apo lëshim teknik, por për mospërputhje substanciale që prekin besueshmërinë e vetë dokumentit të përdorur për të provuar përmbushjen e një kriteri të kualifikimit..

Kjo kontratë u nënshkrua në 4 kopje autentike, ku secilës palë i mbeten nga dy kopje	
<b>Punëdhënësi Euro-Model sh.p.k.</b>	<b>VE Punësuari</b>
<b>Rufat Dushica</b>	<b>Hasan Ukaj</b>
Nënshkrimi 	Nënshkrimi 
<b>Data e nënshkrimit</b>	<b>Vendi i nënshkrimit</b>
<b>20.04.2026</b>	<b>Gjilan</b>

- Për rrjedhojë, mospërputhjet e mësipërme përbëjnë bazë të mjaftueshme që GOE të konsiderohet i papërgjegjshëm për mosplotësimin e kërkesës nr. 7 te dosjes se tenderit, si dhe që OSHP, në ushtrimin e kompetencave të saj sipas nenit 104,105 dhe 116 të LPP-së, të verifikojë nëse në këtë procedurë janë paraqitur të dhëna të rreme ose dokument i falsifikuar dhe, në rast të konstatimit të këtyre rrethanave, të zbatojë masat e parashikuara në nenin 99.2 të LPP-së.
- Për më tepër, edhe sikurse të mos ekzistonin rrethanat e tjera të lartcekura, duke marrë parasysh moshën e personit të propozuar Hasan Ukaj (74 vjeç) dhe dispozitat e nenit 67 paragrafi 1.4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës në Kosovë, sipas të cilit kontrata e punës sipas fuqisë ligjore ndërpritet me arritjen e moshës së pensionimit prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç, paraqitja e një kontrate të rregullt pune me orar të plotë (40 orë në javë) për një person mbi këtë moshë paraqet rrethanë relevante për vlerësimin e natyrës juridike dhe përputhshmërisë së këtij angazhimi me qëllimin e kërkesës së tenderit për dëshmimin e kapacitetit profesional të stafit.

Veçanërisht duke pasur parasysh formave të tjera të lejuara të angazhimit për punë dhe detyra specifike pas arritjes së moshës së pensionimit.

### Pika e tretë

#### 9. Nuk e përmbush kriterin e dhënies së kontratës - ofertën e renditur me çmimin më të lartë ndër ofertat e përgjegjshme.

- Autoriteti Kontraktues – Agjencioni Pyjor, si kriter për dhënien e kontratës, në nenin 21.1 të FTD-së, e ka paraqitur çmimin më të lartë.
- Duke u bazuar në procesverbalin e hapjes së tenderëve të datës 20.04.2026, në lotin 2 kanë paraqitur ofertat e tyre OE ose GOE si në vijim:

Emri i Operatorit ekonomik	Çmimi me TVSH	Rezultati i vlerësimit
Pylla Sh.p.k.	134,277.00	Eliminuar – është pajtuar me rezultatin e AK pasi nuk ka paraqitur kerkese per rishqyrtim
GOE Euro-Model&Perspektiva V	108,155.43	Suksesshëm (fitues per LOT 1)
NTSH Dardani	131,766.14	suksesshëm (fituesper lotet: 2, 6 dhe 9
Rabit Latifi B.I.	156,452.63	Eliminuar (ankimuar ne AK dhe OSHP)

- Duke u bazuar në rezultatin e procesit të ekzamimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, të njoftuar zyrtarisht me anë të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së dhe Letrave Standarde për tenderuesit, dhe duke iu referuar radhitjes së çmimeve të ofertave të paraqitura, konstatohet se oferta e GOE-së Euro-Model & Perspektiva V, e shpërblyer me kontratë për Lot 1 në vlerën 108,155.43 €, është në mënyrë substanciale dhe të dukshme më e ulët se oferta e OE ankues Rabit Latifi B.I., në vlerën 156,452.63 €. Në raport me kriterin e përcaktuar në nenin 21.1 të FTD-së, duke qenë se në rastin konkret kemi të bëjmë me procedurë shitjeje, dhe interesi financiar i AK-së është shitja operatorit ekonomik me çmimin më të lartë. Ky veprim i AK-së përbën shkelje të drejtpërdrejtë të kriterit të vendosur nga vetë AK në dosjen e tenderit, si dhe të dispozitave relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla. Kjo, pavarësisht arsyeve të pretenduara për eliminimin e OE ankues, të cilat janë të pabazuara dhe do të kundërshtohen me fakte dhe prova konkrete në vijim të kësaj ankese, e që dëshmojnë se tenderi i paraqitur nga ana jonë i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.
- Bazuar në gjendjen faktike të konfirmuar në e-prokurimi dhe dokumentacionin e ofertës së paraqitur nga GOE Euro-Model & Perspektiva V Shpk, në raport me kriteret e dosjes së tenderit, rezulton se ky GOE i kishte përmbushur kërkesat për shpërbllim me kontratë për Lot 2, pasi kishte paraqitur çmimin më të lartë prej 28,034.14 €. Arsyetimi i AK-së, i dhënë në letrën standarde për eliminimin nga Loti 2, se GOE nuk e ka plotësuar kërkesën nr. 9 lidhur me listën e projekteve (kontratave) nga lëmia e shfrytëzimit të pyjeve të realizuara në tri vitet e fundit, me arsyetimin se mungon referenca, është i pabazuar dhe në kundërshtim me dokumentacionin e paraqitur në ofertë, si dhe me pikën 4.3 të UPP-së. Sipas kërkesës së dosjes së tenderit, pragu minimal i referencave për Lotin 2 ishte

10,000.00 €, ndërsa GOE kishte paraqitur referenca në vlerë totale prej 73,467.93 €, vlerë që tejkalon jo vetëm pragun për Lotin 2, por edhe pragun prej 60,000.00 € të kërkuar për Lotin 1.

- Pra, nga dokumentacioni i paraqitur rezulton qartazi se kërkesa lidhur me referencat për Lotin 2 ishte përmbushur plotësisht, madje tejkaluar ndjeshëm mbi pragun minimal të kërkuar, çka e bën të pabazuar arsyetimin e AK-së për eliminimin e këtij GOE. Në këto rrethana, veprimet e AK-së dhe, rrjedhimisht, rezultati i vlerësimit dhe vendimi i ZPP-së, krijojnë bazë të arsyeshme për të dyshuar në ekzistencën e një koordinimi ose marrëveshjeje të fshehtë ndërmjet GOE Euro-Model & Perspektiva V dhe OE NTSH Dardani. Kjo për faktin se eliminimi i GOE-së Euro-Model & Perspektiva V nga Loti 2, është në kundërshtim me dokumentacionin e ofertës dhe dispozitat e LPP-së, dhe ka krijuar mundësinë që OE "NTSH Dardani" të shpërblehet me kontratë me çmimin dukshëm më të ulët prej 22,077.37 €, duke i mundësuar fitimin e gjithsej tre loteve. Njëkohësisht, si rezultat i këtij vlerësimi për të cilin kemi dyshim se është i koordinuar, GOE "Euro-Model & Perspektiva V" është shpërblyer me Lotin 1, ndonëse kishte paraqitur çmimin më të ulët ndër operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kriterin e çmimit më të lartë të përcaktuar në nenin 21.1 të FTD
- Në bazë të rrethanave të mësipërme, rezultati përfundimtar i kësaj procedure, sipas të cilit GOE Euro-Model & Perspektiva V u shpërblye me Lotin 1 pavarësisht se kishte paraqitur çmimin më të ulët, ndërsa OE NTSH Dardani u shpërblye me Lotin 2 pavarësisht se kishte paraqitur çmimin më të ulët pasi GOE Euro-Model & Perspektiva V u eliminua pa bazë ligjore nga ky lot, ndonëse kishte paraqitur çmimin më të lartë dhe e përmbushte dhe tejkalonte kërkesën e dosjes së tenderit për të cilin AK kishte marrë shkas ta eliminojë, krijon bazë të arsyeshme për të dyshuar në ekzistencën e një koordinimi ose marrëveshjeje të fshehtë ndërmjet këtyre operatorëve ekonomikë, rezultatet e së cilës janë reflektuar edhe në veprimet dhe vendimmarrjen e Autoritetit Kontraktues. Dhe si rezultat i këtij vlerësimi, secili operator ekonomik është shpërblyer me lotin nga i cili ka përfituar, duke prodhuar një rezultat që bie ndesh me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit, cenon konkurrencën efektive dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, si dhe dëmton interesin financiar të Autoritetit Kontraktues.

**Në vijim paraqiten pretendimet ankimore dhe faktet e paraqitura në mbështetje të tyre në Kërkesën për Rishqyrtim të datës 12.06.2026 që dëshmojnë shkelje të dispozitave përkatëse të LPP-së dhe akteve nënligjore në fuqi.**

#### **Pretendimet e njejta të paraqitur në Kërkesën për Rishqyrtim të datës 12.06.2026**

10. Pretendimet ankimore të paraqitura në vijim janë të njëjtat pretendime që janë ngritur fillimisht në Kërkesën për Rishqyrtim të datës 12.06.2026. Duke qenë se pas Njoftimit mbi Vendimin e AK dhe Letres Standarde dhe pas vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ankuesi nuk kishte pasur qasje në dokumentacionin e plotë të procedurës së prokurimit, argumentimi i tyre është zhvilluar dhe plotësuar në këtë ankesë mbi bazën e dokumenteve zyrtare të siguruara më pas, si dhe në kundërshtim të arsyetimit të dhënë nga AK në Vendimin për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim.

Për rrjedhojë, kjo ankesë nuk paraqet sqarim dhe argumentim më të detajuar të pretendimeve të ngritura fillimisht në Kërkesën për Rishqyrtim, të mbështetura me prova shtesë dhe analiza juridike që nuk kanë qenë objektivisht në dispozicion të ankuesit në momentin e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim.

11. Në Kërkesën për Rishqyrtim është pretenduar se Autoriteti Kontraktues ka eliminuar në mënyrë të kundërligjshme ofertën e OE Rabbit Latifi B.I. për Lotin 1, ndonëse ajo ishte ofertë e përgjegjshme dhe kishte paraqitur çmimin më të lartë, në kundërshtim me kriterin e dhënies së kontratës të përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Njëkohësisht është pretenduar se GOE "Euro-Model & Perspektiva V", i rekomanduar për kontratë, nuk i përmbushte kërkesat e Dosjes së Tenderit, pasi i mungonin dëshmi të kërkuara për kualifikim, përfshirë referencat e kërkuara për përvojën përkatëse dhe vërtetimi mbi përmbushjen e obligimeve ndaj Agjencisë Pyjore të Kosovës. Gjithashtu është ngritur dyshimi lidhur me faktin se i njëjti operator ekonomik është vlerësuar si i papërgjegjshëm për Lotin 2 për shkak të mungesës së referencave, ndërsa me të njëjtin dokumentacion është shpallur fitues për Lotin 1, duke krijuar trajtim të pabarabartë dhe vlerësim kontradiktor të së njëjtës ofertë.
12. Po ashtu, në Kërkesën për Rishqyrtim është kundërshtuar edhe arsyeja e eliminimit të OE Rabbit Latifi B.I. lidhur me angazhimin e inxhinierit të pylltarisë, duke theksuar se OE ankues kishte paraqitur kontratë të vlefshme me inxhinierin përkatës, kishte ofertuar vetëm për Lotin 1 dhe kishte përmbushur plotësisht kërkesat e Dosjes së Tenderit. Është pretenduar se çdo marrëdhënie eventuale e inxhinierit me operatorë të tjerë ekonomikë nuk mund t'i ngarkohej si përgjegjësi OE ankues, përderisa ai kishte paraqitur dokumentacion të rregullt dhe të vlefshëm për dëshmimin e kapacitetit profesional të kërkuar.
13. Në Kërkesën për Rishqyrtim është pretenduar gjithashtu se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 6, 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe aktet nënligjore në fuqi, duke cenuar interesin e ligjshëm të OE ankues përmes një vlerësimi të pabarabartë dhe në kundërshtim me kriteret e Dosjes së Tenderit. Për këto arsye është kërkuar anulimi i vendimit për eliminimin e ofertës, eliminimi i shkeljeve ligjore të konstatuara dhe shpërblymi me kontratë të OE Rabbit Latifi B.I., si operatori ekonomik i përgjegjshëm që kishte paraqitur çmimin më të lartë dhe kishte përmbushur të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit.

**Shtojcë:** Kundërshtim i arsyetimit të vendimit të AK në përgjigjen ndaj pretendimeve të OE ankues dhe faktet e siguruara gjatë procesit të qasjes zyrtare në të dhenat e aktivitetit.

14. Në arsyetimin e vendimit të kontestuar, Autoriteti Kontraktues nuk ka shqyrtuar në themel pretendimet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim, por është kufizuar në një interpretim formal të dispozitave ligjore, pa analizuar faktet dhe provat e paraqitura nga OE ankues, si dhe pa iu përgjigjur argumenteve thelbësore mbi të cilat mbështetej kërkesa për rishqyrtim. Përkundrazi, është mbështetur vetëm në rrethanat që i ka konsideruar në favor të vendimit të saj dhe të GOE fitues, duke anashkaluar faktet vendimtare të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim.
15. Sa i përket pretendimit lidhur me kundërshtimin e arsyetimit të AK për eliminimin e ofertës së OE ankues si të papërgjegjshme, me arsyetimin se i njëjti inxhinier i pylltarisë ishte paraqitur si kapacitet profesional edhe në ofertën e një operatori tjetër ekonomik

pjesëmarrës në të njëjtën procedurë të prokurimit, duke u konsideruar se nuk ishte përmbushur kërkesa nr. 7 sipas nenit 69.8 të LPP-së dhe nenit 18.9 të Rregullores Nr. 002/2024, në Kërkesën për Rishqyrtim, konsiderojmë se ky arsyetim është i pabazuar në aspektin faktik dhe juridik.

- Pa qenë e nevojshme të përsëriten në detaje pretendimet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim, ankuesi i ka zhvilluar dhe argumentuar ato më gjerësisht në Pretendimin e Parë të kësaj ankese, duke i mbështetur me fakte dhe prova konkrete.
- Pa qenë e nevojshme të përsëriten në detaje pretendimet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim, ankuesi i ka zhvilluar dhe argumentuar ato më gjerësisht në pretendimin e parë të kësaj ankese, duke i mbështetur me fakte dhe prova konkrete.

Megjithatë, nga analiza e mësipërme rezulton se arsyetimi i ZPP të AK nuk qëndron as në aspektin faktik dhe as në atë juridik. Së pari, arsyetimi i vendimit të AK bie ndesh me vetë kriterin e përcaktuar në kërkesën 7 të DT, siç e kemi sqaruar në Pretendimin e Parë të kësaj ankese, për faktin se na ka shpallur të papërgjegjshëm në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe nenin 56.3 të LPP-së, duke u mbështetur në një kriter të vetëkrijuar sipas konsideratave tjera, e jo në kërkesat reale të dosjes së tenderit dhe të ligjit. Së dyti, AK-ja është kufizuar vetëm në konstatimin se i njëjti inxhinier i pylltarisë ishte paraqitur edhe në ofertën e një operatori tjetër ekonomik, dhe mbi këtë bazë ka nxjerrë përfundimin se nuk ishte përmbushur kërkesa për disponueshmëri ekskluzive të kapacitetit profesional, pa analizuar faktet dhe provat e paraqitura nga OE ankues dhe pa arsyetuar pse ato nuk janë marrë në konsideratë. Siç është trajtuar në Pretendimin e Parë, ky arsyetim mbështetet në një vlerësim joobjektiv të gjendjes faktike dhe juridike të krijuar në këtë procedurë, duke bërë interpretim të gabuar të nenit 69.8 të LPP-së dhe nenit 18.9 të Rregullores Nr. 002/2024, duke u atribuar atyre një kërkesë për disponueshmëri ekskluzive që nuk rezulton nga përmbajtja e tyre dhe që nuk ka qenë e përcaktuar në dosjen e tenderit. Po ashtu, AK-ja ka anashkaluar faktin se operatori tjetër ekonomik, në ofertën e të cilit ishte paraqitur i njëjti inxhinier, ishte eliminuar nga procedura dhe nuk kishte ushtruar mjete juridike kundër atij eliminimi, rrethanë që, siç është argumentuar më lart, e bën të paqëndrueshme vetë bazën e eliminimit.

16. Sa i përket konstatimit të AK-së në vendimin e kontestuar, me të cilin është refuzuar si i pabazuar pretendimi i OE ankues lidhur me mospërmbushjen e kërkesës nr. 4 të nenit 4.1 dhe 4.2 të FTD-së (Vërtetimi nga APK) nga GOE Euro-Model SH.P.K. dhe Perspektiva V SH.P.K., i rekomanduar për dhënie të kontratës për Lotin 1, me arsyetimin se i njëjti posedon vërtetimet e lëshuara nga Agjencia Pyjore e Kosovës me numrat e protokollit NP-1600 dhe NP-1601, të datës 20.04.2026, të cilat dëshmojnë përmbushjen e kërkesës së dosjes së tenderit lidhur me këtë kriter, ky konstatim nuk qëndron dhe bie ndesh me dokumentacionin e vetë ofertës së ngarkuar në platformën e-prokurimi.

- Siç është argumentuar mjaftueshëm në pretendimin e parë të kësaj ankese, nga skedari DOK 1.rar i GOE Euro-Model & Perspektiva V rezulton se janë ngarkuar vetëm dokumentet "7 Kerkesa AP Perspektiva.pdf" dhe "KERKESA APK.pdf", të cilat përmbajnë vetëm kërkesën drejtuar APK-së, e jo vërtetimin e kërkuar nga DT-ja, dhe asnjë dokument me numrat e protokollit NP-1600 ose NP-1601 nuk figuron i ngarkuar në dosjen e ofertës.

- Meqenëse konstatimi i AK-së nuk përputhej me dokumentacionin e ofertës, ankuesi i ka kërkuar shprehimisht ZPP-së së AK-së, bazuar në nenin 10 paragrafët 3, 4 dhe 5 të LPP-së, që të tregojë dhe vërtetojë me dëshmi konkrete në cilin skedar të ofertës ndodhen këto vërtetime dhe t'i vërë në dispozicion kopjet e tyre. Deri më sot, AK-ja nuk ka identifikuar asnjë skedar, nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokument dhe nuk ka ofruar asnjë provë që mbështet konstatimin e saj. Kjo mungesë e plotë e përgjigjes konkrete vërteton se konstatimi i AK-së se pretendimi ynë është i pabazuar, nuk mbështetet në ndonjë provë reale, por përbën pretendim të pambështetur nga ana e vetë AK-së, në kundërshtim me detyrimin e saj për transparencë dhe arsyetim të bazuar në fakte sipas nenit 7 dhe nenit 10 të LPP-së.
- Rrjedhimisht, ky veprim i AK-së përbën ndryshim të aspektit material të ofertës pas afatit të ofertimit, në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së dhe pikën 10.1 të Udhëzuesit për Prokurimin Publik, duke favorizuar GOE Euro-Model & Perspektiva V në kundërshtim me parimin e barazisë dhe trajtimin jodiskriminues të përcaktuar në nenin 7 të LPP-së.

### Përfundim me propozime

Andaj duke marrë parasysh të gjitha arsyet, faktet dhe provat e paraqitura si më lart, OE ankues Rabbit Latifi B.I. (NTP BLINI & CATI) i drejtohet OSHP-së me këtë ankesë, duke kërkuar që pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, administrimit të shkresave të lëndës dhe provave në shqyrtim kryesor, e në pajtim me nenin 104, 105 dhe 107 dhe 117 të LPP-së, të merr këtë:

### V E N D I M

- I. **MIRATOHET E BAZUAR** në tërësi Ankesa e parashtruar nga OE Rabbit Latifi B.I. (NTP BLINI & CATI);
- II. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK për Lot 1 i datës 08.06.2026, duke përfshirë Letren Standarde për tenderuesin e eliminuar OE ankues dhe Letren Standarde për Tenderuesin e Suksesshem për lot 1 Idihur me GOE Euro-Model SH.P.K. dhe Perspektiva V SH.P.K., për aktivitetin e e prokurimit "Shitja e masës drusore sipas Planit Menaxhues me pyje për vitin 2026 në DR-Mitrovicë ,DR-Ferizaj , DR-Gjilan dhe Blinajë - Lot 1"
- III. **OBLIGOHET** AK që lëndën për lot 1 ta kthejë në RIVLERËSIM, duke ndërmarrë veprime korrigjuese në mënyrë që procesi i vlerësimit dhe krahasimin të tenderëve të bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore dhe dispozitat e nenit 59 dhe 60 lidhur me nenin 1,6,7 dhe 24 të LPP dhe dispozitave të ndërlidhura që rregullojnë situatat e tilla të RRPP

#### 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Obligimit të kompensimit të shpenzimeve procedurale, kompensimit të dëmit, dhe fitimit të humbur që do kërkohet pastaj.

#### 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura *Bashkëngjitet të gjitha provat e cekura.*